



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

MODULI LËNDOR ME ZGJEDHJE
“PARANDALIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE NË MJEDISE PUNE”

Tiranë, 2021

I. Hyrje

Edukimi i brezit të ri me kulturën e paqes, tolerancës, mirëkuptimit, respektimit të diversitetit, dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve apo konflikteve në situata e mjedise të ndryshme (në shkollë, familje, punë e shoqëri) përmes dialogut është një ndër pritsshmëritë dhe synimet e formimit të të rinjve përmes kurrikulës së arsimit parauniversitar në Shqipëri.

Në përputhje me këtë synim të arsimit parauniversitar, në arsimin e mesëm të lartë është e nevojshme të bëhet një punë intensive për edukimin e nxënësve për parandalimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Të rinjtë janë punonjësit dhe punëdhënësit e së nesërme. Të rinj të arsimuar mirë do të thotë punonjës dhe punëdhënës të ardhshëm më të aftë, pasi ata do të fillojnë të bashkëveprojnë në vendin e punës me një formim dhe përgatitje të përshtatshme për sa i takon fushës së marrëdhënieve të punës dhe mosmarrëveshjeve në vendin e punës.

Në këtë kontekst, është zhvilluar kjo kurrikul e cila synon të orientojë, aftësojë dhe mbështesë nxënësit me aftësi në fushën e parandalimit dhe zgjidhjes efektive të mosmarrëveshjeve përmes negociimit dhe dialogut.

“Parandalimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedise pune” është menduar të ofrohet si modul kurrikular për të gjithë nxënësit në arsimin e mesëm të lartë dhe rekomandohet të zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje ose në kurrikulën me bazë shkolle si një mundësi zgjedhje për nxënësit, për të plotësuar më së miri nevojat dhe interesat e tyre.

Bazuar në burimet e të nxënit, mësuesi planifikon ecurinë e zbatimit të këtij moduli sipas përzgjedhjes së rezultateve të të nxënit në tematikat përkatëse. Elementet bazë të strukturës së modulit janë:

- **Titulli i modulit**
- **Përmbajtja e modulit** tregon fushën ku janë fokusuar veprimtaritë e nxënësve gjatë trajtimit të modulit.

- **Kohëzgjatja e modulit** tregon se në sa orë mësimore do të trajtohen veprimtaritë mësimore të të gjitha rezultateve të të nxënit.
- **Tabelat për secilën tematikë** të cilat përmbajnë rezultatet e të nxënit dhe konceptet kryesore të tematikës.
- **Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit** përmbajnë disa rekomandime të përgjithshme për organizimin, zbatimin e modulit, burimet e të nxënit dhe mjetet mësimore, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e modulit.

II. MODULI: PARANDALIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE NË VENDIN E PUNËS

II.1 Përmbajtja e modulit: Nëpërmjet këtij moduli nxënësi do të zhvillojë dhe zgjerojë njohuritë e tij në lidhje me koncepte të rëndësishme si ankesat dhe konfliktet, pajtimi dhe ndërmjetësimi, kultura e dialogut dhe aftësive negociuese për të parandaluar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore në shoqëri dhe vendin e punës. Gjithashtu, në pjesën më të madhe të tij, nxënësi do të përfshihet në veprimtari praktike që zhvillohen, të cilat mundësojnë kuptimin dhe aftësimin e tyre për të vepruar nesër si punëdhënës apo punëmarrës që zgjidhin në mënyrë paqësore dhe efektive mosmarrëveshjet dhe situatat konfliktuale që mund të krijohen.

II.2 Kohëzgjatja e modulit: Moduli “Parandalimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedise pune” zhvillohet me 1 orë në javë dhe gjithsej në 36 orë mësimore vjetore. Moduli specifikon me afërsi peshën (orët e sugjeruara) për secilën tematikë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore. Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë, ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra – tjetrën. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e modulit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të modulit, ndërsa janë të lirë të ndryshojnë me 10% - 15% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

Tabela 1: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

| Tematika | Parandalimi i mosmarrëveshjeve | | Orë të sugjeruara |
|-----------------|---|---|--------------------------|
| Nëntematikat | Aftësitë bazë të të rinjve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve | Parandalimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedise pune | |
| Orët | 20 | 16 | Gjithsej 36 orë |

Tematika: Parandalimi i mosmarrëveshjeve

Përshkrimi i tematikës:

Tematika “Parandalimi i mosmarrëveshjeve” zhvillon te nxënësit njohuri, shkathtësi dhe qëndrime në lidhje me kuptimin e konceptit të mosmarrëveshjeve dhe konfliktit, përcaktimin e qëndrimeve që mbahen ndaj këtyre dy fenomeneve, si dhe njohjen e parimeve që duhen mbajtur parasysh gjatë zgjidhjes së një konflikti ose mosmarrëveshjeje.

Përmes veprimtarive praktike, projekteve kurrikulare e strategjive të tjera ndërvepruese, nxënësi aftësohet në kuptimin e drejtë të koncepteve që lidhen me mosmarrëveshjet dhe konfliktet.

Rezultatet e të nxënit

Nëntematika: Aftësitë bazë të të rinjve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

| Njohuritë | Shkathësitë | Qëndrimet/vlerat |
|--|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kompetencat bazë në menaxhimin e mosmarrëveshjeve • Bashkëpunimi mes të rinjve, kyç i suksesit • Krijimi i sensit të komunitetit dhe kolegjalitetit mes të rinjve • Reflektimi mbi perceptimet e secilit • Këndvështrimet e ndryshme • Ndikimi i aspekteve kulturore në sjelljet e individëve • Pikëpamjet mbi konfliktin • Vetëvlerësimi dhe kuptimi për veten • Vlerat dhe bindjet personale • Vlerësimi i dallimeve tek të tjerët • Vetërespekti dhe konflikti • Konfliktet e brendshme të individit | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon kompetencat bazë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; • dallon aftësitë kryesore të nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur efektivisht mosmarrëveshjet; • dallon bashkëpunimin mes të rinjve, si kyç të suksesit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; • demonstroi rolin e një dëgjuesi efektiv; • angazhohet në veprimtari praktike lidhur me komunikimin, dëgjimin efektiv e menaxhimin e emocioneve; • identifikon komunikimin si efektiv në zgjidhjen e konflikteve; • shpjegon rëndësinë që ka ndjenja e besimit në trajtimin e konflikteve; • vlerëson rëndësinë e besimit në vendosjen e komunikimit të efektshëm; • ilustron rolin e gjuhës se gjesteve për një komunikim të efektshëm; • vlerëson rëndësinë e të qenit dëgjues i mirë; | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij; • ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale; • demonstroi bashkëpunim gjatë punës në grup; • tregon objektivitet kur kërkon të dhëna dhe informacion për të bërë të vlefshme shpjegimet dhe argumentimet e saj/tij; • vlerëson diversitetin shoqëror, kulturor dhe mjedisor; • vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve; • respekton përpjekjet personale dhe ato të grupit. |

| | | |
|--|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve • Elementët e një komunikimi efektiv • Ndjenja e besimit në trajtimin e konflikteve • Roli i gjuhës së gjesteve • Përdorimi i pyetjeve • Dëgjuesi efektiv • Steriotipizimi • Paragjykimi • Toleranca • Empatia • Të drejtat, përgjegjësitë dhe konflikti | <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan përdorimet e pyetjeve të hapura dhe të mbyllura; • përdor pyetje të hapura dhe të mbyllura për të nxitur ose penguar komunikimin; • aftësohet për të bërë pyetje të hapura; • formulon pyetje të formës joakuzuese, të cilat nxitin bisedën; • argumenton rreziqet e stereotipizimit; • vlerëson të dyja anët e një problemi; • përkufizon paragjykimin; • shpjegon se në çfarë mënyre lindin dhe zhvillohen paragjykimet dhe diskriminimi; • shpjegon problemet që lidhen me etiketimin; • përshkruan mënyrat në të cilat shprehen emocionet; • njeh mënyrat e ndryshme në të cilat njerëz të ndryshëm shprehin të njëjtat emocione; • vlerëson tolerancën në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; • përfshihet në veprimtari praktike lidhur me shprehjen e emocioneve, besimin, etiketimin etj; • ilustron idetë e tij për konfliktin; | |
|--|--|--|

| | | |
|--|---|-----------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> identifikon empatinë si faktor të rëndësishëm në menaxhimin e mosmarrëveshjeve dhe konfliktit; identifikon dhe shpjegon burimet kryesore të konfliktit; përshkruan se si mund të zgjidhen konfliktet në kontekste të ndryshme; përcakton se në ç'mënyrë vlerat personale ndikojnë në mënyrën e zgjidhjes së konflikteve; identifikon rolin e qëndrimeve, ndjenjave dhe sjelljeve të tyre në zgjidhjen e konflikteve; argumenton rëndësinë e empatisë në situata konflikti; përcakton faktorët që ndikojnë në sjelljet e tyre gjatë situatave konfliktuale; dallon zgjedhjet e shumta kur vendosin sesi të veprojnë në një situatë konflikti; përshkruajnë lidhjen që ekziston midis të drejtave dhe përgjegjësisive në situata konflikti. | |
| Nëntematika: Parandalimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedise pune | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Ndërveprimet në shoqëri dhe vendin e punës | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruan llojet e ndërveprimeve; | <p>Nxënësi:</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Aktorët e përfshirë në ndërveprime • Llojet e bashkëpunimeve • Konfliktet dhe mosmarrëveshjet si pjesë e jetës • Sistemet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve • Llojet e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve në vendin e punës • Përkeqësuesit dhe moderuesit e mosmarrëveshjes • Negocimi dhe rëndësia e tij • Mënyrat e negociimit • Parandalimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve • Bisedimet kolektive • Bashkëpunimi në vendin e punës • Pajtimi/ndërmjetësimi • Arbitrazhi dhe gjykimi • Standardet ndërkombëtare të punës | <ul style="list-style-type: none"> • sjell argumente mbi dinamikën e ndërveprimeve referuar faktorëve të ndryshëm; • prezanton kuptimin mbi konfliktin dhe mosmarrëveshjen; • përshkruan dallimin mes konfliktit dhe mosmarrëveshjes; • vlerëson aspektin kulturor të konfliktit apo mosmarrëveshjes; • dallon dhe shpjegon dukuritë që e shoqërojnë konfliktet; • shpjegon hapat e përshkallëzimit të konfliktit; • identifikon llojet e mosmarrëveshjeve në vendin e punës; • sjell shembuj të llojeve të mosmarrëveshjeve në vendin e punës; • angazhohet në veprimtari praktike lidhur me mosmarrëveshjet; • vlerëson tërësinë e përkeqësuesve të mosmarrëveshjeve në vendin e punës; • vlerëson moderuesit që çojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; | <ul style="list-style-type: none"> • paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij; • ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale; • demonstroi bashkëpunim gjatë punës në grup; • tregon objektivitet kur kërkon të dhëna dhe informacion për të bërë të vlefshme shpjegimet dhe argumentimet e saj/tij; • vlerëson diversitetin shoqëror, kulturor dhe mjedisor; • vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve; • respekton përpjekjet personale dhe ato të grupit. |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Konventat kryesore që lidhen me punën • Legjislacioni kombëtar mbi marrëdhëniet e punës dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve të punës • Institucionet dhe organizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës në Shqipëri | <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan rëndësinë e negociimit; • identifikon mënyra të negociimit; • përfshihet në veprimtari praktike lidhur me negociimin; • sjell shembuj të mënyrave të negociimit; • vlerëson rolin e bashkëpunimit në vendin e punës; • përshkruan ndërmjetësimin/pajtimin si mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; • dallon arbitrazhin dhe gjykimin si forma të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; • dallon disa nga konventat kryesore ndërkombëtare të punës; • evidenton pjesë të legjislacionit shqiptar që lidhen me marrëdhëniet në punë; • dallon instrumente ligjorë që kanë në fokus zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës. | |
|--|--|--|

III. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR REALIZIMIN E MODULIT

Për realizimin e modulit, mësuesit duhet të përdorin, sa më shumë të jetë e mundur, diskutimet, debatet, punën në grupe, veprimtaritë konkrete, projektet, konkurset. Kjo formë mësimdhënieje i ndihmon nxënësit t'i përshtatin lehtësisht njohuritë në praktikë. Realizimi i veprimtarive mësimore me natyrë praktike ka rëndësi parësore për arritjen e rezultateve të parashikuara të të nxënësit. Për këtë sugjerohet që mësuesi të planifikojë mësimin, duke mbajtur parasysh rezultatet e të nxënësit të parashikuara në programin e modulit, si dhe të trajtojë termat dhe konceptet kryesore duke e vendosur theksin te zbatimi në praktikë i tyre. Mësuesi përdor materiale të ndryshme (shënime, fotokopje, literaturë ndihmëse etj.) për arritjen e rezultateve të të nxënësit të këtij moduli.

Mësuesi për realizimin e modulit duhet të pozicionohet më tepër në rolin e moderatorit, se sa të mësuesit tradicional. Nëse moduli **zgjidhet nga nxënësit për t'u zhvilluar në kurrikulën me zgjedhje**, vlerësimi kryhet me të njëjtat procedura si lëndët/modulet e tjera të kurrikulës me zgjedhje. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*p.sh., vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular, test përmbledhës etj.*). Nëse **moduli zgjidhet nga nxënësit për t'u zhvilluar në kurrikulën në bazë shkolle** vlerësimi bazohet vetëm te shlyerja e modulit (pra është pa notë).